



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1188 Prot.

Tiranë, më datë 05.10.2022

VENDIM

Nr.476, datë 05.10.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 05.10.2022:

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin “Ndërtim i Ri Arkitektoniko-Volumor Dy Katësh +Nënçati+Podrum”, Zonë Historike Shkodër 2022 Rruga “Gjuhadol”, Brenda Kufirit Qendër Historike Shkodër, me aplikues Zef Cuni dhe zhvillues Marin Gjonej;
 - Në projekt të përfshihen rilevime të objektit kufitar në fasada apo prerje në mënyrë që të gjykohet mbi lartësinë por duke u referuar vetëm nga pamjet 3D të paraqitura në projekt, objekti i propozuar nuk e tejkalon lartësinë e çatisë së objektit kufitar;
 - Në projekt të eliminohen daljet voluminore në çati (baxhot);
 - Trajtimi arkitektonik i fasadës së objektit të paraqitet i thjeshtuar.
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të zbatohen dhe mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

